

VENDIM
Nr. 161, datë 20.10.2020

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “ENERGIJA DOO VETERNIK” NR. 317, SERIA F15, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 141, DATË 21.11.2015**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3, dhe nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/5 prot., datë 13.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Energija DOO Veternik” sh.p.k., për rinovim licence në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energija DOO Veternik” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1086 prot., datë 6.10.2020, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 6.1.2015 është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” (QKB).

- Shoqëria “Energija DOO Veternik” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 317, seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 141, datë 21.11.2015.

- Afati i fundit për aplikim nga shoqëria “Energija DOO Veternik” sh.p.k., për rinovimin e kësaj licence, referuar “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ishte data 21.9.2020.

- Shoqëria “Energija DOO Veternik”, sh.p.k. nuk ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës, pasi aplikimi i saj është paraqitur në ERE në datën 6.10.2020.

- Shoqëria “Energija DOO Veternik” sh.p.k. ka kryer pagesën për aplikimin për rinovim.

- Shoqëria “Energija DOO Veternik” sh.p.k. ka depozituar një dokumentacion të konsiderueshëm bashkëlidhur aplikimit të saj për rinovim të licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, por ky aplikim nuk është paraqitur në afat sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Sipas nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6, të këtij neni, brenda 1 muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energija DOO Veternik” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 317, seria F15, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 141, datë 21.11.2015.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti